



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 790/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-86610-09-20-2018, me objekt: Loti I “Punime Pusi”, me fond limit 2,094,873 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

Ankimues:

BO “Mikael - Grup” sh.p.k & “Neim” sh.p.k.
Adresë: Vashtmi, Libonik, Korçë.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë.
Adresa: Rruga “28 Nëntori” Lagjia nr. 7, Korçë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.09.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit, “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-86610-09-20-2018, me objekt: Loti I “Punime Pusi”, me fond limit 2,094,873 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor Ndërnarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 01.10.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Avdolli” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Mikael Grup” shpk & “Niem” shpk	1,599,800 lekë	skualifikuar
3. “Hidrotek - KO” shpk	1,888,100 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 08.10.2018, bashkimi operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen:

Operatori juaj nuk ka paraqitur siguracion per mjetin sonde hidraulike. Nga dokumentacioni i shqyrtuar per mjetin autosonde te marre me kontrate qeraje, me targe ACMT74 siguracioni i paraqitur ka perfunduar ne daten 25.07.2018, datë e cila është përpara hapjes së procedurës së prokurimit, rrjedhimisht nuk jane plotesuar kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 5 e DST ne te cilin kerkohen:

5.Disponimi i mjeteve te meposhtme: Lloji i Makinerive Sasia Pronesia.

Sonde hidraulike cope 1 ne pronesi ose me qera.

Kur jane me qera te paraqitet: kontrata e qerase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit

II.4.1. Në datën 11.10.2018 bashkimi operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

[...]Ne daten 08.10.2018 nga ana e Autoritetit Kontraktor na eshte derguar vleresimi per tenderin me objektr “Punime pusi” (loti 1), ku bashkimi i perkohshem i operatoreve “Mikael Grup” shpk & “Niem” shpk eshte skualifikuar per arsye se per mjetin me sonde me targe AMCT 74 eshte paraqitur siguracion i cili ka mbaruar ne daten 25.07.2018. Ky vendim eshte i padrejte per sa me poshte vijon:

1-Ne rradhe te pare ne dokënenat e tenderit, tek shtojca nr.11 “kriteret e vecanta” ne DT gjejme shprehimisht faktin se per mjetet qe disponohen nevojitet vetem nje deklarate sipas shtojces 9, ku citohet: “Per disponimin e te gjithë mjeteve te mesiperme ofertuesit duhet te paraqesin nje deklarate mbi disponimin e makinerive sipas shtojces 9”. Ne kendveshtrimin e ankuesit plotesimi i kesaj deklarate eshte i mjaftueshem per te provuar disponueshmerine e mjeteve. Pavaresisht se nga ana e AK jane kerkuar dhe dokumentat e mjetit dhe pavaresisht se nuk eshte ankimuar ky fakt ne jemi te mendimit se keto kerkesa jane te teperta.

2-Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave nuk jane zbatuar te gjitha te drejtat dhe tagrat qe ka ky i fundit per te kryer nje vleresim objektiv. Referuar nenit 66, pika 3,paragrafi i dyte te VKM nr.914, date 29.12.2014, ndryshuar Komisioni ka te drejte te kerkoje sqarime nga ofertuesi, E mbeshtetim kete pretendim ne faktin se akti i kualidimit te mjetit i cili mbaron me 31.07.2019 ka te pasqyruar shoqerine e cila ka leshuar policen e sigurimit (Eurosig ne rastin konkret) dhe numrin serial te saj 180249838. E gjitha kjo gjen mbeshtetje ligjore ne Udhëzimin nr.2 , date 17.04.2014 te Ministrise se Transporteve dhe Infrastruktures. Mosvleresimi nga ana e komisionit i ketij fakti qe mjeti i cili eshte pajisur me certifikate te kontrrollit teknik detyrimisht ka pasur dhe policen e sigurimit te tij si dhe mosmarrja parasysh e dispozites ligjore ku komisioni ka tagra te kerkoje sqarime nga ofertuesit si dhe te kryeje verifikime, na krijon bindjen se ndodhemi ne masen 100% para nje vleresimi jo te drejte. [...].”

Sa me siper kerkojme rivleresim.

II.4.2. Në datën 12.10.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 899/2 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 18.10.2018 bashkimi operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankese të paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 951 prot, datë 24.10.2018, protokolluar me tonën me nr. 1619/2 prot, datë 25.10.2018, me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues Mikael Grup sh.p.k*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k. se: “*Operatori juaj nuk ka paraqitur siguracion per mjetin sonde hidraulike, pasi nga dokumentacioni i shqyrtuar për mjetin autosondë të marrë me kontratë qeraje, me targë ACMT74 siguracioni i paraqitur ka përfunduar në datën 25.07.2018, datë e cila është përpara hapjes së procedurës së prokurimit, rrjedhimisht nuk janë plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 5 e DST*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 11, *Loti I “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5, e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:*

5. Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	PRONESIA
Sonde hidraulike	cope 1	ne pronesi ose me qera

Për disponimin e të gjitha mjeteve të mësipërme ofertuesit duhet të paraqesin një deklaratë mbi disponimin e makinerive sipas shtojcës 9.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike (me goma) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.

Kur janë me qera të paraqitet: kontrata e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk kanë leje qarkullimi duhet të paraqitet: dokumenti që vërtetojnë pronësinë e mjeteve/pajisjeve dhe në rast se janë me qera duhet paraqitet kontrata e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e tyre.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Marrëveshja Bashkëpunimi e Përkohshme me Nr. 5927 Rep, Nr. 4378 Kol, datë 28.09.2018 ku shënohet edhe ndarja e punimeve që do të kryhen për Lotin e I, Punime Pusi “Mikael - Grup” do të realizojë 95% të punimeve të pusit dhe “Niem” shpk do të realizojë 5% të punimeve të pusit dhe pjesmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë sipas përqindjes më mëposhtëm:

“Mikael - Grup” sh.p.k	95 %
“Niem” sh.p.k	5 %

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterit të më sipërcituar bashkimi operatorëve ekonomikë ankimes “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k., ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik “Mikael Grup” shpk

- 1. Shtojcën 9 mbi disponimin e makinerive.*
- 2. Kontratë Qiraje me Nr. 6631 Rep Nr. 2953 Kol, datë 10.11.2017, e lidhur pranë noterit publik midis Qiradhënësit M.K dhe Qiramarrësit shoqërisë “Mikael Grup” shpk për mjetin autosondë, të markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74.*
- 3. Certifikatë Pronësie me Nr. TRF0388916 në emër të “M. K” për mjetit autosonde të markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74.*
- 4. Leje Qarkullimi me Nr. TRF0388916 në emër të “M. K” për mjetit autosonde të markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74*
- 5. Certifikatën e Kontrrollit teknik të Mjetit me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74, e vlefshme deri më 31.07.2019.*
- 6. Policë Sigurimi për mjetin autosonde të markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74, e vlefshme deri më 25.07.2018.*
- 7. Certifikatë Pronësie me Nr. KOD0918511 në emër të shoqërisë “Mikael Grup” për mjetit JCB, me nr shasie 0461059, dhe targa ABMT 51.*
- 8. Leje Qarkullimi me Nr. KOD0918511 në emër të shoqërisë “Mikael Grup” për mjetit JCB, me nr shasie 0461059, dhe targa ABMT 51.*
- 9. Certifikatën e Kontrrollit teknik të Mjetit me nr shasie 0461059, dhe targa ABMT 51, e vlefshme deri më 03.04.2019.*
- 10. Policë Sigurimi për mjetin JCB, me nr shasie 0461059, dhe targa ABMT 51, e vlefshme deri më 04.03.2019.*
- 11. Certifikatë Pronësie me Nr. KOD0831711 në emër të shoqërisë “Belishta” për mjetit Kamionçin, me nr shasie WDB6014171P287887, dhe targa KO8061B.*
- 12. Leje Qarkullimi me Nr. KOD0831711 në emër të shoqërisë “Belishta” për mjetit Kamionçin, me nr shasie WDB6014171P287887, dhe targa KO8061B.*

13. *Certifikatën e Kontrrollit teknik të Mjetit Kamionçinë me nr shasie WDB6014171P287887, dhe targa KO8061B, e vlefshme deri më 27.11.2018.*
14. *Policë Sigurimi për mjetin Kamionçinë, me nr shasie WDB6014171P287887, dhe targa KO8061B, e vlefshme deri më 04.07.2019*

Operatori ekonomik “Niem” shpk

1. *Shtojcën 9 mbi disponimin e makinerive.*
2. *Certifikatë Pronësie me Nr. KOF0218016 në emër të shoqërisë “Niem” shpk për mjetin Ekskavator me nr shasie CGG0006499, me targë ABMT55.*
3. *Leje Qarkullimi nr Nr. KOF0218016 në emër të shoqërisë “Niem” shpk për mjetin Ekskavator me nr shasie CGG0006499, me targë ABMT55*
4. *Certifikatën e Kontrrollit teknik të Mjetit me nr shasie CGG0006499, dhe targa ACMT55.*
5. *Policë Sigurimi për mjetin Ekskavator me nr shasie CGG0006499, me targë ABMT55.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.1.6. Në nenin 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.*

“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të

bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokurë duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”.

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, *makineritë*, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat standarte të tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Mikael Grup” sh.p.k rezulton se, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, shoqëria në fjalë ka paraqitur Kontratë Qiraje me Nr. 6631 Rep Nr. 2953 Kol, datë 10.11.2017, e lidhur pranë noterit publik midis Qiradhënësit M.K dhe Qiramarrësit shoqërisë “Mikael Grup” shpk për mjetin autosondë, të markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74 se bashku me Certifikatën e Kontrollit teknik të Mjetit. Ndërkohë nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit është përcaktuar së për vërtetimin e disponueshmërisë së mjetit të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm: ***Për mjetet që shënohen në***

regjistra publike (me goma) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit. **Kur janë me qera të paraqitet:** kontrata e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Referuar dokumentacionit të sa më sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “Mikael Grup” sh.p.k rezulton se ky operator ekonomik për mjetin e marrë me qera autosondë e markës Caterpillar, të tipit CCC, me nr shasie 22097, dhe targa ACMT74, nuk ka paraqitur policën e sigurimit të mjetit të vlefshme.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Mikael Grup” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga bashkimit të operatorëve ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k & “Niem” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-86610-09-20-2018, me objekt: *Loti I “Punime Pusi”*, me fond limit 2,094,873 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor Ndërnarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1619 Protokoli, Datë 18.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha